



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Menaxhimit Financiarë

Nr. 1676 prot

Pukë, më 30.09.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 5 datë 30.09.2025

PËR: “RIMIRATIMIN E VENDIMIT NR.28 DATË 04.09.2025 ‘PËR “HEQJEN NGA KONTABILITETI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA QË NUK JUSTIFIKOHEN ME DOKUMENTACION FINANCIARË DHE LIGJORË” PAS MOSMIRATIMIT NGA PREFEKTI I QARKUT SHKODËR.

Në mbështetje të nenit 54 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pasi u shqyrtua mosmiratimi i Prefektit të Qarkut Shkodër me shkresën nr. 588/1, datë 19.09.2025, si dhe relacioni i paraqitur nga Kryetari i Bashkisë për argumentet ligjore dhe praktike mbi vendimin, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë për herë të dytë, pa ndryshime, vendimin nr. 28, datë 04.09.2025, me objekt: “Për heqjen nga kontabiliteti të detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiarë dhe ligjorë”.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i dërgohet Prefektit të Qarkut për dijeni.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin.

Drejtore e Financës


Fiqirete Latifi

Juristi

Endrit Kraja

KRYETARI

Rrok DODAJ



Mr. 1676/P. 2025

Date: 30.09.2025

RELACION

Drejtuar: Keshilit Bashkiak

Te nderuar keshilltarë

Në mbështetje të nenit 54 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pasi u shqyrtua mosmiratimi i Prefektit të Qarkut Shkodër me shkresën nr. 588/1, datë 19.09.2025, si dhe relacioni i paraqitur nga Kryetari i Bashkisë për argumentet ligjore dhe praktike mbi vendimin.

Analiza e bërë nga prefekti nuk qëndron dhe po ju japim argumentin

-Në paragrafin e parë prefekti shprehet.

Sipas VKM nr.50/2014, një shtyllë themelore e strategjisë është parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura. Për këtë qëllim, duhet të ishte zhvilluar nga ju një analizë e shkaqeve të pagesave të vonuara dhe miratimi i masave specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve. Parimet në të cilat duhet të mbështeten pagesat për detyrime duhet të jenë në mënyrë transparente, proporcionale, të besueshme, realiste dhe të drejtë. Radha e pagesave për secilënkategori të detyrimeve të papaguara do ndjekë parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar. Pagesat do të fillojnë nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga institucionet përkatëse, të dokumentacionit që vërteton kyerjen e punimeve/shërbimeve/dorëzimin e mallrave dhe/ose kërkesën për rimbursimin e TVSh, Tatim Fitimit. Radha e pagesës do të ndryshojë vetëm nëse ka patregullsi në dokumentacion që kërkon verifikime të mëtejshme.

Komenti: Arsyetimi është i pabazuar në ligj, administrata aktuale nuk mund mbaje përgjegjësi për veprime ose mos veprime të para 15 viteve, për kronologjinë e pagesave të vonuara, për kundrazin asnjë nga subjektet e përfshira në projekt nuk kanë patuar ankese apo kundërshtitë.

-Në paragrafin e dytë

Sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi, detyrimet e lindura në qeverisjen vendore për punimet epapaguara për projektet e infrastrukturës vendore të financuara nga fondi për zhvillimin e rajoneve, do të verifikohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përpara se nëpunësit autorizues të

njësive të qeverisjes vendore të dërgojnë urdhër pagesën me dokumentacionin shoqërues pranë degës së thesarit. Detyrimet e prapambetura në lidhje me pretendimet e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar do të trajtohen pas auditimit të borxhit nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe do të paguhet duke respektuar parimin që detyrimet më të vjetra financiare do të marrin prioritetin më të lartë (shih më tej Ministria e Financës)

Rasti që është trajtuar me këtë vendim të këshillit bashkiak, rezulton që nuk është bërë një analizë e mirëfilltë duke nxjerrë personat përgjegjës, penalitetet etj....

Në të gjithë rastet është bërë analizë financiare për çdo rast, ku janë nxjerrë kontrata, faturat dhe afatet për pagesë. Referanca e prefekturës nuk qëndron se nuk ajnë me fonde të FZSH dhe as persona me aftësi të kufizuar.

-Ne paragrafin e tretë

Në atë periudhë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura janë miratuar disa akte si; Akti Normativ Nr.1/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr.160/2014 për buxhetin e 2015", VKM Nr.510/2015 "Për miratimin e procedurave për transferim të të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrurëzuara, të arkivave dhe Ado dokumentacioni fjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", VKM Nr.664/2015 "Për shpërndarjen e fondit transitor për zbatimin e reformës së re administrative territoriale", NJQV u janë transferuar fonde për detyrimet e trashëguara nga bashki/komuna. Kjo do të thotë që paraprakisht duhet të kishit të gjithë këtë dokumentacion apo arsyet e mosgjatjes.

Aktualisht Bashkia nuk mund të kthehet në vitin 2015, kjo është arsyeja që disa here subjekteve ju është dërguar shkresa për sjellje dokumentacioni duke ju lënë dhe afat. Po nga KLSH nuk janë lene që detyrimet pa dokumentacion të behen pagesa.

Përmbledhje e situatës

Institucioni ynë ka shqyrtuar detyrimet e prapambetura të kontabilizuara më parë, me synim shlyerjen e tyre sipas rregullave buxhetore. Megjithatë, në procesin e verifikimit është konstatuar mungesa e dokumentacionit shoqërues (kontrata, fatura, procesverbale dorëzimi etj.), i cili është i domosdoshëm për të provuar ligjshmërinë e detyrimit financiar.

Argumentimi ligjor

1. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor dhe akteve nënligjore për financat publike, çdo pagesë nga buxheti i shtetit duhet të mbështetet mbi dokumentacion të plotë dhe të verifikuar. Në mungesë të tij, autorizimi i shpenzimit është i paligjshëm.

2. Detyrimet e kontabilizuara vite më parë, për të cilat sot mungon dokumentacioni, nuk mund të autorizohen për pagesë nga organet aktuale, pasi kjo do të krijonte përgjegjësi të padrejtë për drejtuesit aktualë dhe do të binte ndesh me parimin e ligjshmërisë.

3. Sipas ligjit për financat publike dhe Kodit Penal, përgjegjësia për autorizimin e një pagese të parregullt bie mbi personin që e firmos. Për këtë arsye, nuk mund të procedohet me pagesë derisa të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm.

4. Rekomandimet e auditimit nga KLSH kanë theksuar se shlyerja e detyrimeve të prapambetura lejohet vetëm mbi bazën e dokumentacionit justifikues, në të kundërt krijohet rrezik për dëmshmëri financiare.

Përfundim

Për sa më sipër, institucioni ynë nuk mund të mbajë përgjegjësi për veprime të kryera në administratat e mëparshme dhe nuk mund të autorizojë pagesën e detyrimeve të kontabilizuara pa

dokumentacionin përkatës. Autorizimi i pagesës në këto kushte do të përbënte shkelje të ligjit dhe do të ngarkonte padrejtësisht drejtuesit aktualë me përgjegjësi financiare dhe ligjore.

**Të miratojë për herë të dytë, pa ndryshime, vendimin nr. 28, datë 04.09.2025, me objekt:
“Për heqjen nga kontabiliteti të detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiarë dhe ligjorë”.**

Drejtores e Financës

Fiqirete Latifi



KRYETARI

Rrok DODAJ



22.09.25

H. Teresku
F. Idrizi
Z. N. N. N.
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 588/1
prot.

Shkodër, më 3.09.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 28, datë 04.09.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe Aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 54, neni 64, shkronja "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40, pika 3, shkronja "h", VKM Nr.50, datë 5.2.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", Udhëzimi nr.5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar, VKB Pukë Nr. 64/2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", të ndryshuar, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Nr.1482/4 prot., datë 08.09.2025 "Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Pukë", shqyrtoi VKB Pukë Nr. 28, datë 04.09.2025 "Për heqje nga kontabiliteti të detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor".

Pas analizimit, Prefekti ju sqaron si më poshtë vijon:

Detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj / kontratë / marrëveshje / vendim gjykatë i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes vendore. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njësive të qeverisjes vendore, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.

Sipas VKM nr.50/2014, një shtyllë themelore e strategjisë është parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura. Për këtë qëllim, duhet të ishte zhvilluar nga ju një analizë e shkaqeve të pagesave të vonuara dhe miratimi i masave specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve.

Parimet në të cilat duhet të mbështeten pagesat për detyrime duhet të jenë në mënyrë transparente, proporcionale, të besueshme, realiste dhe të drejtë. Rradha e pagesave për secilën

kategori të detyrimeve të papaguara do ndjekë parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar. Pagesat do të fillojnë nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga institucionet përkatëse, të dokumentacionit që vërteton kryerjen e punimeve/shërbimeve/dorëzimin e mallrave dhe/ose kërkesën për rimbursimin e TVSh, Tatim Fitimit. Radha e pagesës do të ndryshojë vetëm nëse ka parregullsi në dokumentacion që kërkon verifikime të mëtejshme.

Sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi, detyrimet e lindura në qeverisjen vendore për punimet e papaguara për projektet e infrastrukturës vendore të financuara nga fondi për zhvillimin e rajoneve, do të verifikohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përpara se nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes vendore të dërgojnë urdhër pagesën me dokumentacionin shoqërues pranë degës së thesarit. Detyrimet e prapambetura në lidhje me pretendimet e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar do të trajtohen pas auditimit të borxhit nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe do të paguhen duke respektuar parimin që detyrimet më të vjetra financiare do të marrin prioritetin më të lartë (shih më tej Ministria e Financës)

Rasti që është trajtuar me këtë vendim të këshillit bashkiak, rezulton që nuk është bërë një analizë e mirëfilltë duke nxjerrë personat përgjegjës, penalitetet etj....

Në atë periudhë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura janë miratuar disa akte si; Akti Normativ Nr.1/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr.160/2014 për buxhetin e 2015", VKM Nr.510/2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*", VKM Nr.664/2015 "*Për shpërndarjen e fondit transitor për zbatimin e reformës së re administrativo territoriale*", NJQV u janë transferuar fonde për detyrimet e trashëguara nga bashki/komuna. Kjo do të thotë që paraprakisht duhet të kishit të gjithë këtë dokumentacion apo arsyet e mosgjetjes.

Gjithashtu, edhe raporti përfundimtar i auditimit financiar i KLSH korrik 2024, e konsideron një gjetje me risk të lartë mosshlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe ju është rekomanduar një planifikim të një grafiku për likuidim të tyre.

Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon procedim të mëtejshëm, pasi ka mungesë të analizës së thelluar për detyrimet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

